



Njësia i Prokurimit

Istog: datë, 02.07.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Istogut, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.06.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik PROFESSIONAL ALARM L.L.C., ENVER MALOKU, 108, 10 000, PRISHTINË lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:

“MIREMBAJTJA DHE ZGJERIMI I RRJETIT TE KAMERAVE TE SIGURISE NE KOMUNEN E ISTOGUT.”.

, me Nr. të Prok: 633-20-2147-2-2-1/ 633-020-025-221.

nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik PROFESSIONAL ALARM L.L.C., ENVER MALOKU, 108, 10 000, PRISHTINË lidhur me aktivitetin e prokurimit “MIREMBAJTJA DHE ZGJERIMI I RRJETIT TE KAMERAVE TE SIGURISE NE KOMUNEN E ISTOGUT me Nr. të Prok: Jashtëm 633-20-2147-2-2-1 dhe i Mbrendëshëm 633-025-221-kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN e AK –së, të datës: 26.06.2020 te publikuar ne web-faqe te KRPP-së .
- 2. Vërtetohet vendimi i AK për NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë: 26.06.2020.
- 3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.**

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues qendron prane rekomandimit te bëre nga Komisioni vleresues edhe pas Vendimit të Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues i ka respektuar Parimet themelore të Prokurimit Publik: Parimin e barazisë Jo diskriminimit, ruajtjen e parasë Publike dhe të gjitha kërkesat e kërkuara në Fletë Dukoment të Tenderit.

Komisioni vleresues ka bere llogaritjen e sasive te peraferta me çmimet e ofruara per njesi nga OE ,dhe si rezultat kane shperblyer OE TE PERGJEGJSHEM ME Çmimin më të lire në total,ja radhitja e çmimeve totale te ofertave konkurruese:

- Grupi i operatoreve Ekonomik "Impact shpk, Cimi @elektronic", me çmim prej 14,819.70 €,
- N.P.SH. Elting electronics", me çmim prej 13,623.50 €,
- N.T.SH. Samiri Soft", me çmim prej 18,020.50 €,
- K.S. "Besa Security", me çmim prej 14,595.67 €,
- "Professional Alarm"L.L.C me çmim prej 17,655.00 €,

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit